



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

01 ref. 05
28.04.2021

Mbështetur në nenet 92.4 dhe 93(4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenet 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, nenet 53 dhe 55 të Ligjit nr. 05/L-031 të procedurës së përgjithshme administrative, si dhe nenin 8.1.4 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Anulohet** Thirrja publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM, e shpallur nga Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) më 25 janar 2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetime

Më 25 janar 2021, Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve (KIESA) ka shpallur “Thirrje publike për subvencionim me mjete financiare për NMVM”. Thirrja është botuar në sajtin e Ministrisë.

Teksti i thirrjes përcakton qëllimin e saj si vijon:

- në preambulë: “[m]e qëllim të zvogëlimit të deficitit tregtar dhe përmirësimit të kapaciteteve prodhuese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), rritjen e investimeve, të eksportit, konkurrueshmërisë dhe hapjen e vendeve të reja të punës”; dhe
- në brendi: “me qëllim të ngritjes së kapaciteteve prodhuese, shpallim thirrje të hapur për përkrahjen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme për blerjen e makinerisë prodhuese/përpunuese.”

Për të siguruar ligjshmërinë dhe efektshmërinë në punën e Agjencisë, kabineti i Ministres dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë kanë shqyrtuar në hollësi thirrjen dhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve. Ky shqyrtim ka shpërfaqur këto të meta thelbësore të thirrjes:

- nuk përcakton kriteret të qarta që mundësojnë përzgjedhjen objektive të përfituesve, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, mosdiskriminimit, transparencës, objektivitetit dhe pritshmërisë së arsyeshme nga nenet 4 dhe 6–8 të Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative;

- nuk përcakton kritere të qarta që sigurojnë përmbushjen e misionit ligjor të Agjencisë, sipas neneve 22–23 të Ligjit nr. 04/L-220 për investimet e huaja;
- nuk përcakton kritere të qarta që sigurojnë përmbushjen e synimit të cekur në preambulën e thirrjes;
- nuk merr parasysh veprimtarinë kryesore të aplikuesve për t’u siguruar se përkrahja u jepet ndërmarrjeve që kanë synim ngritjen e kapaciteteve prodhuese dhe eksportuese, çka bie ndesh me qëllimin e shpallur në thirrje;
- nuk përmban mekanizma që mbrojnë çrregullimin e tregut të lirë, pa marrë parasysh vlerën *de minimis* të ndihmës, meqë përfituesit shumë lehtë mund të përdorin subvencionet për të penguar kapacitetet prodhuese dhe eksportuese të konkurrentëve; dhe
- nuk siguron shpenzim efektiv të parasë publike.

Duke vërejtur se të metat e sipërcekura e bëjnë thirrjen të paligjshme dhe me qëllim për të vendosur ligjshmërinë, u vendos si në dispozitiv.

Rozeta HAJDARI

Ministre



U dërgohet:

- KIESA-s
- Kabinetit të Ministres
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Departamentit Ligjor
- Arkivit